

## **Analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.**

Më datë 07.Shkurt 2022, Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në zbatim të urdhrorit nr. 8 datë 18.01.2022 “Për kryerjen e analizës vjetore të veprimtarisë së Departamenteve të KLSH-së për vitin 2021”, zhvilloi në mjediset e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, analizën vjetore mbi aktivitetin e këtij departamenti për vitin 2021. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit z. Arben Shehu, Drejtori i Përgjithshëm znj. Mariola Llanaj, Drejtori i Departamentit z. Kozma Kondakçiu, Rektori i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë z. Roland Zisi, pedagogia e fakultetit të Ekonomisë Veronika Durmishi si dhe stafi auditues i këtij Departamenti.

Analiza vjetore e hapi Kryetari i KLSH-së z. Arben Shehu, i cili falënderoi rektorin Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, z. Roland Zisi për vazhdimin e traditës dhe pranimin e kërkesës për kryerjen e analizës së departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit të KLSH-së në ambientet e këtij Universiteti. Në vazhdim të fjalës Kryetari i KLSH-së vuri theksin në rëndësisë e këtij auditimi si dhe siguroi audituesit e departamentit për mbështetjen institucionale për rritjen e profesionale dhe kapaciteteve audituese.



Në fjalën e tij Rektori i Universitetit z. Roland Zisi falenderoi Kryetarin e KLSH-së z. Shehu mbi përzgjedhjen e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë për kryerjen e kësaj analize vjetore, si një mundësi e mirë për njohjen nga stafi i Universitetit të rezultateve të punës nga një institucion si Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Më pas u vijua me përmbledhjen e veprimtarisë audituese të Drejtorit të Departamentit z. Kozma Kondakçiu, paraqiti Raport-Analizën vjetore të ndërtuar në 3 kolona kryesore:

- Veprimtaria e Departamentit për vitin 2021 nëpërmjet statistikave;
- Analiza SWOT dhe
- Objektivat për të ardhmen.

Në vazhdim analiza vazhdoi me prezantimin e disa prej auditimeve të kryera gjatë vitit 2021 nga ana e audituesve Elira Cukalla, Benard Haka dhe Rodjan Alimerkaj.

Konkluzionet e analizës i përmbledhi Drejtori i Përgjithshëm znj. Mariola Llanaj, e cila falënderoi stafin për punën e kryer si dhe kujtoi rëndësinë që ka përmirësimi i punës së gjithë secilit në rritjen e cilësisë së auditimeve.